

20200310589

## LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

### Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 180/19 dhe 275/19), pas nenit 107-d shtohet titull i ri dhe pesë nene të reja 107-gj, 107-e, 107-zh, 107-z dhe 107-x, si vijojnë:

### “Përcaktimi i stazhit të sigurimit

#### Neni 107-gj

(1) I Siguruari i cili ka qenë në marrëdhënie të rregullt të punës, përkatësisht në punë në bazë të cilës ka qenë i paraqitur për sigurim të detyrueshëm social, ndërsa nga ana e detyrësit për llogaritjen dhe pagimin e kontributit nuk është paguar kontributi për sigurim pensional dhe invalidor, mundet vetë për veten të kryejë pagesë të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Pagesa për kontributin nga paragrafi (1) të këtij neni ka të bëjë për atë periudhë për të cilën i siguruari dorëzon kërkesë për pagimin e kontributit, me kusht që të ketë qenë i paraqitur në sigurimin e detyrueshëm social.

(3) Baza për llogaritje dhe pagesë të kontributeve është 20% nga rroga mesatare për vitin paraprak nga viti në të cilin është dorëzuar kërkesa për pagim të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, të shpallur nga Enti Shtetëror i Statistikës.

(4) Pagimi i kontributeve nga paragrafi (1) të këtij neni bëhet sipas shkallës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor të përcaktuar me ligj.

(5) Pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor mund ta kryejnë edhe anëtarët e familjes nga neni 57 të këtij ligji.

#### Neni 107-e

(1) E drejta për pagimin e kontributit nga neni 107-gj paragrafi (1) i këtij ligji realizohet në bazë të kërkesës së dorëzuar në Fond nga i siguruari nga neni 107-gj paragrafi (1) i këtij neni, ose nga anëtarët e familjes nga neni 57 të këtij ligji.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 107-zh

Fondi miraton aktvendim për pagimin e kontributit nga neni 107-gj paragrafi (1) të këtij ligji, nëse konstaton se janë plotësuar kushtet në vijim:

- i siguruari ka qenë i paraqitur në sigurimin e detyrueshëm social, që përcaktohet nga të dhënat e evidencës amë në Fondin me kërkesë paraprake të vendosur për fillimin dhe ndërprejten e sigurimit të përcaktuar në evidencën amë të Fondit,

- kontributi për sigurimin pensional dhe invalidor për periudhën për të cilën i siguruari ka qenë i paraqitur në sigurimin e detyrueshëm social nuk është paguar, përkatësisht nuk është i paguar plotësisht, që përcaktohet me procesverbalin e Fondit dhe

- detyrësi për pagimin e kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor është në falimentim, ndërsa i siguruari është i çlajmëruar nga sigurimi ose obliguesi është i shlyer nga regjistrat në të cilat evidentohen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose regjistër tjetër para marrjes në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilën Fondi me detyrë zyrtare siguron prova në bazë të shkëmbimit të të dhënave, ose në bazë të zbatimit paraprak të M11/2.

#### Neni 107-z

Pagimi i kontributeve na neni 107-gj paragrafi (1) të këtij ligji bëhet pas miratimit të aktvendimit nga neni 107-zh të këtij ligji.

#### Neni 107-x

Si stazh i sigurimit llogaritet koha kur i siguruari ka qenë në marrëdhënie pune, përkatësisht në punë në bazë të cilës është paraqitur në sigurimin e detyrueshëm social nëse tërësisht është paguar kontributi i përcaktuar në aktvendimin nga neni 107-zh të këtij ligji."

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të zbatohet pas një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.